



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Më 27.02.2024

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi, Nënkrjetarë

Zahir Doda, DKA

Fadil Ahmetaj, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Fadil Guri-ZKK

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Gzim Morina-FSK

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Mundësia e organizimit të një trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënës të shkollave
- 4.Trajtimi i qenve endacak
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Në pikën e dytë të rendit të ditës për periudhën në mes dy takimev Kryetari fjalën ia dha rreshter Fadil Ahmetaj.

Fadil Ahmetaj – Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë.

Ka rënje të veprave kriminale në këtë periudhë kohore dhe të raportuara në muajin janar janë 29 raste dhe në muajin shkurt 15 raste , që don të thot se trendi i këtyre veprave ka rënje.

Gjendja e sigurisë nëpër shkolla është pak shqetësuese ngase është përshkallzuar dhuna nëpër shkolla.Ndikim në përhapjen e kësaj dhune kan edhe rrjetet sociale të cilët po e nxisin këtë dhunë.Hiq më larg se dje e kishmi një rast të rrahjes në mes të dy grupeve të nxënësve të cilën zënkën e kan nisur në rrjetet sociale e ekcesi është bërë në shkollë.Lidhur me këtë rast policia ka marr informacionin,ka dalë në vendin e ngjarjes dhe është duke u marrë me masat e mëtutjeshme procedurale.

Thënë në përgjithsi ka rritje të përhapjes së dhunës apo sjelljeve huligane nëpër shkolla dhe ne si institucione duhet me i ndërmarrë masat paraprake për parandalim.

Xhoba jemi duke vënë ndaj shkelësve të ligjit në komunikacion por jemi duke punuar edhe me qështjen e parkingjeve ilegale.

3.Mundësia e organizimit të një trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënës të shkollave

Bujar Bajra:sektori i emergjencave ka organizuar ligjerata në të kaluarën dhe fokusin e kemi pasur tek parashkollorët.Për organizim të trajnimeve me klasa më të larta ne edhe mundë të i bëjmë por që ka një kosto pasi që është i kushtueshëm.Siq jeni njoftuar edhe më parë është një

OJQ që ka shprehur gadishmëri për trajnime falas për qështje të emergjencave dhe është mirë që të kontaktohen dhe të bëhet një plan i trajnimeve nëpër shkolla.

Fadil Guri:prezent e kemi edhe FSK -në dhe mendoj që me pak mjete financiare qështjen e trajnimeve mundë ta kryejnë më mirë se çdo kush tjetër.Le ti marrin propozimet tona dhe të i përcjellin tek eprorët e tyre e neve na mbetet të bëjmë planin përmes Drejtorisë së Arsimit.

Gzim Morina:sa i përket trajnimeve për mbrojtje nga zjarri neve na nevojitet një koordinim ngase është garda kombëtare që mirret specifikisht me këto trajnime.Kët propozim ne e përcjellim tek eprorët dhe së bashku me ju mundë ta bëjmë një plan për mënyrën e realizimit.Lidhur me ndihmën e parë nuk ka implikime bugetore ngase mjetet i kemi dhe neve na duhet vetëm hapsira dhe nxënësit.Deri në mbledhjen e radhës do ju informoj.

Kryetari: është mirë një koordinim në mes neshë dhe këto trajnime janë të mirseardhura.Sa i përket implikimit buxhetor ne mundë të mendojmë që në të ardhmën në planin e punës të planifikojmë edhe buxhet me qëllim që këso lloj trajnimesh të organizohen për çdo vjet.

Fadil Guri:trajnimet mendoj që të fillojnë kët vit që nuk besoj se nevojitet ndonjë buxhet ndërsa për vitet tjera të planifikohet edhe buxheti.

Naim Hysa:trajnime të tilla janë të mirseardhura por që mendoj që pos FSK ne mundë të angazhojmë edhe organizata të shoqërisë civile ngase numri i shkollave është i madh e ne mundemi të koordinohemi në kët aspekt .Kryqi i Kuq Komunal më herët është marrë me një trajnim të tillë në bashkëpunim me njësitin e zjarrfikësve dhe kët mundë ta bëjmë edhe tani duke u koordinuar në mes vehte.FSK mundë të kontriboj në trajnime fushore me kapacitetet e tyre.

Kryetari:janë të mirseardhur për bashkëpunim edhe organizatat e shoqërisë civile dhe në të ardhmën të bëhet një plan i përbashkët në realizim të trajnimeve.

Fidaim Fazliu:ne po flasim për një trajnim të mundshëm për mbrojtje nga zjarri me nxënës dhe kët gjë më së miri mundë ta bëjnë njësiti i zjarrfikësve dhe besoj se nuk mundë të ket ndonjë implikim buxhetorë ndërsa për pjesën teorike mundë ta kërkojmë edhe ndihmën e FSK-së dhe organizatat e shoqërisë civile.

Gzim Morina:ne kontributin më të madh mundë ta japim në trajnime për ofrimin e ndihmës së parë ku në kët rast mundemi edhe të bashkëpunojmë me njësitin e zjarrfikësve për punën praktike.

Kryetari:Drejtoria e Arsimit dhe sektori i emergjencave mundë ta bëjnë një plan të detajuar ndërsa implementimin e këtij plani e bëjmë në mënyrë të koordinuar.

Bujar Bajra:në rast të aksidenteve që ndodhin gjat shfaqjes së zjarrit në mjedise të ndryshme, hapi i parë duhet tw jet ndihma e parë kështu që duhet një koordinim në mes akterëve.Për me e kry siq duhet një operacion në rast të paraqitjes së zjarreve ne duhet të i ndërmarrim disa hapa

paraprak duke bërë shenjëzimin për evakuim mbrenda objekteve që mendoj që çdo institucion duhet ta ket.

Zahir Doda: prioriteti i ynë është siguria e nxënësve dhe ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me FSK-në në dy segmente: vetdijësim rreth mjeteve piroteknike dhe për mjetet plasëse siq janë minat. Sa i përket qështjes që po diskutojmë mua më është ofruar një OJQ për një trajnim të tillë por që kërkojnë financim. Për shkak të mundësive të limituara buxhetore unë as që kam planifikuar një trajnim të tillë por që dyert janë të hapura për çdo kend që ofron trajnime falas. Unë i kam ftuar edhe OJQ-të që mirren me rininë shkollare që përmes projekteve të tyre të bëjmë diçka në lidhje me sigurinë nëpër shkolla. Për sigurinë e nxënësve nëpër shkolla një kontribut të madhë kanë dhënë Policia e Kosovës që shfrytëzojnë rastin edhe të falënderoj për bashkëpunim por që është zhgënjyes neglizhenca e Entit për Punë Sociale të cilët i kam ftuar në takim por që nuk ju kanë përgjigjur ftesës. Roli i tyre në aspektin e sigurisë së fëmijëve është i madh ngase janë ata të cilët duhet të mirren me prind për sjelljet e fëmijëve të tyre në rrugë.

4. Trajtimi i qenve endacak

Kryetari: çështja e qenve endacak është brengosëse në tërë vendin dhe ne si komunë i kemi marrë disa masa me aq sa kemi pasur mundësi, ku për këtë më mirë do të na tregoj Bujari.

Bujar Bajra: Komuna ka pasur një kontratë dyvjeqar për trajtimin e qenve endacak dhe kjo kontratë tashmë ka përfunduar. Në këtë periudhë dyvjeqare janë trajtuar 432 qen. Për krijimin e kushteve për trajnimin e qenve endacak qeveria është zotuar për ndërtimin e strehimoreve por që deri më sot nuk ka asgjë konkrete.

Fadil Guri: duhen të gjinden forma për evidentimin dhe regjistrimin e tyre. Projekti ka qenë dyvjeqarë por që ne nuk po e dijmë se si janë trajtuar.

Kryetari: duhet të punohet në strategji që e kanë bërë AVUK dhe të ndërtohen strehimore në nivel regjioni.

5. Të ndryshme

Menduh Krasniqi: kohëve të fundit kemi pranuar raporte nga policia për mos respektim të orarit të punës së barnatoreve dhe ne i kemi shqyrtuar këto raporte dhe kemi vendosur xhoba ndaj atyre që nuk ju kanë përmbajtur orarit të punës. Nganjëherë po ndodhë që këto raporte që po na vijnë po janë të mangëta. Ka dyshime nga policia që dikush po i lajmron këto biznese në lidhje me atë se kush po i bje këto raporte. Ne si inspektorat çdo xhobë e lëshojmë me aktvendim duke u bazuar në raportin e policisë por me emër jo. Nëse pala ankuese dëshiron të dhëna shtesë ne i krijojmë mundësi për qasje në dokumente zyrtare. Lidhur me këto raporte të policisë për bizneset farmaceutike deri më tash kemi lëshuar 4 xhoba. Në kuadër të planit të punës ne kemi planifikuar edhe inspektime edhe jashtë orarit të punës që shumë shpejtë kemi me fillu. Sa i përket orarit të punës së bizneseve ne kemi inspektorin që mirret me këtë punë por që do të inspektojmë edhe parkingjet ilegale që padyshim do të kërkojmë edhe asistencën e policisë.

Fadil Ahmetaj: asistimi i policisë nuk do të mungoj sa herë që kërkohet nga ana e inspektorëve por që është mirë që kërkesa për asistim të bëhet me kohë.

Kryetari: ka ankesa prej bizneseve inspektimi po bëhet në mënyrë selektive duke i inspektuar disa biznese më shumë e disa jo ,kështu që këto masa të mirren për të gjithë njësoj.

Elmihane Malsiu: deshta të ngris një shqetësim të një nëne të një fëmije me aftësi të veqanta në fshatin Begracë, ku fëmija i sajë ka qenë në një shkollë speciale në Prizren . Ka bërë një kërkesë për të vazhduar shkollimin në Begracë ku në fillim ka qenë pjesë e kësaj shkolle ndërsa tash e ka ndërpre dhe më intereson të dijë se a është e njoftuar DKA për këtë rast dhe çfarë hapa janë ndërmarrë.

Zahir Doda: është një rast që ka bërë jehonë mediatike dhe si rast ka shkuar edhe te avokati i popullit. Është një rast që ne si drejtori nuk mundemi të ofrojmë zgjidhje .Në pyetje është që për këtë fëmijë të përdoret gjuha e shenjave e që ne si komunë nuk mundemi të ofrojmë këtë shërbim. I vetmi institucion që mirret me këto raste është Qendra Burimore në Prizren dhe lidhur me këtë rast i kemi kontaktuar ata dhe përgjigja ka qenë se që vet prindi e ka tërhequr fëmijën nga kjo qendër. Shpenzimet e udhëtimit ne si komunë mundemi edhe të ia mbulojmë por që shërbimi është i pamundur.

Rekomandimet:

1. Të mirren masa parandaluese për format e ndryshme të dhunës nëpër shkolla
2. Të bëhet një plan i trajnimeve për sigurinë nëpër shkolla
3. Tolerancë 0 për bizneset që nuk respektojnë orarin e punës
4. Të gjinden forma për evidentimin dhe regjistrimin e qenve endacak

Kryesoi: Kryetari – Z. Besim Ilazi



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka